

VENDIM
Nr. 253, datë 3.9.2026

**MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 68, DATË 8.4.2025,
“MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘RENEW’ SHPK NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME
KAPACITET TË INSTALUAR 2 mw”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 136, pika 2, të ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 3.9.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 817/7 prot., datë 1.9.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 68, datë 8.4.2025, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘Renew’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 mw’, i ndryshuar”,

konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “Renew” sh.p.k.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 68, datë 8.4.2025, i ndryshuar me vendimin 162, datë 5.6.2026, ka vendosur të licencojë shoqërinë “Renew” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet prodhues 2 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier, për një afat 30-vjeçar.

- Në pikën 4 të këtij vendimi përcaktohet se “Brenda datës 16.8.2026, shoqëria duhet të depozitojë në ERE informacion të përditësuar mbi stafin teknik”. Ndërsa në pikën 5 përcaktohet se ky vendim është objekt rishikimi në rast të plotësimit/mosplotësimit të kushteve në pikën 4.

2. Korrespondenca dhe dokumentacioni i depozituar nga shoqëria

- Në kuadër të zbatimit të kushteve të vendimit të sipërcituar, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 817/6, datë 5.8.2026, shoqëria ka përcjellë “Marrëveshjen e përfundimit të kontratës së shërbimit me shoqërinë ‘Construction Energy Parts’ sh.p.k.”, mbi përfundimin e ofrimit të shërbimit më datë 31.7.2026 dhe “Kontratën e shërbimit të operimit dhe mirëmbajtjes me shoqërinë ‘Kirac Green Energy’ sh.p.k.”, datë 1.8.2026, me afat 2-vjeçar (dyvjeçar)vjeçar, së bashku dokumentacionin e kualifikimit teknik të personelit të angazhuar për ofrimin e shërbimit nga shoqëria “Kirac Green Energy” sh.p.k..

- Duke marrë në konsideratë përmbushjen e kushtit të përcaktuar në pikën 4 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 162/2026, shoqëria kërkon që ERE të reflektojë përmbushjen e tij dhe të procedohet me shfuqizimin në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.

3. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar rezulton se shoqëria ka përmbushur brenda afatit detyrimin e përcaktuar në pikën 4, të vendimit nr. 68, datë 8.4.2025, të ndryshuar, duke paraqitur informacionin/dokumentacionin e përditësuar mbi stafin teknik të angazhuar për operimin dhe mirëmbajtjen e centralit fotovoltaik.

- Sa i përket kërkesës së shoqërisë për shfuqizimin e detyrimit të përcaktuar në pikën 4 të vendimit, vlerësohet se, ndonëse detyrimi për depozitim të informacionit brenda datës 16.8.2026 është përmbushur, sigurimi i kapaciteteve të nevojshme teknike përbën një kërkesë që duhet të përmbushet përgjatë gjithë kohës së ushtrimit të veprimtarisë së licencuar dhe kontrata e shërbimit e paraqitur nga shoqëria ka afat deri më 1.8.2028, vlerësohet që në përfundim të këtij afati shoqëria të depozitojë pranë ERE-s informacion të përditësuar mbi stafin teknik të angazhuar për ushtrimin e veprimtarisë së licencuar.

- Ndryshimi i pikës 4, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 68, datë 8.4.2025, të ndryshuar, nuk cenon zbatimin e pikës 5 të këtij vendimi, e cila mbetet në fuqi dhe do të zbatohet në lidhje me

detyrimin e përcaktuar në pikën 4, sipas përmbajtjes dhe afatit të ri të përcaktuar me këtë vendim.

4. Nevoja për ndryshimin e vendimit

- Në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se një akt administrativ mund të ndryshohet, shfuqizohet apo anulohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë për ta nxjerrë atë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e një ndryshimi në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 68, datë 8.4.2025, i ndryshuar, si vijon:

a) Pika 4 ndryshon dhe bëhet:

“4. Brenda datës 1.8.2028, shoqëria “Renew” sh.p.k. të depozitojë pranë ERE-s informacion të përditësuar mbi stafin teknik të angazhuar për ushtrimin e veprimtarisë së licencuar.”.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “Renew” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), shoqërinë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” (OSSH) sh.a., shoqërinë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” (FTL) sh.a. dhe shoqërinë “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike” (ALPEX) sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vlefshmërinë e vendimit, përveçse kur gjykata vendos ndryshe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti